



## PROCESVERBAL VIII/2021

I mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me datën 24.09.2021 në ora 10<sup>10</sup>.  
Në sallën e mbledhjeve të KPF –së.

Mbledhjen e kryesoi -Kryesuesja e KPF dhe KK-së znj. Kristina Gashi Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Kristina Gashi – Bytyçi;
2. Arian Imeri;
3. Rafiz Sejdiu;
4. Lumnije Morina;
5. Bahrije Hyseni;
6. Shkelzen Selmani dhe
7. Xhavit Zariqi.

### **Rendi i ditës:**

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
4. Propozim - Vendim për caktimin e emrave të Listës rezervë për zonat e qarkullimit publik të Komunës së Ferizajt;
5. Propozim - Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtëshme për vitin 2022;
6. Propozim - Vendim për aprovimin e projekt buxhetit për vitin 2022-2024 dhe
7. Të ndryshme,

### **Hapja e seancës nga Kryesuesja e Kuvendit dhe leximi i pikave të rendit të ditës.**

**Kryesuesja e Kuvendit Kristina Gashi Bytyçi-** Fillimisht dëshirojë të ju uroj punë të mbarë.

#### **1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së:**

Janë të pranishëm gjithsej 6 anëtar të KPF-së

#### **2. Miratimi i rendit të ditës –**

E hap diskutimin Kryesuesja e KPF-së dhe KK-së znj. Kristina Gashi Bytyçi. Pasi që nuk ka diskutime miratohet rendi i ditës nga të gjithë të pranishmit me 6 vota pro.

### **3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te KPF –se:**

E hap diskutimin Kryesuesja e KPF-së dhe KK-së znj. Kristina Gashi Bytyçi, pasi që nuk ka diskutime miratohet procesverbali me 6 vota pro nga anëtarët e KPF-së.

### **4.Propozim - Vendim për caktimin e emrave të Listës rezervë për zonat e qarkullimit publik të Komunës së Ferizajt.**

Fjalën fillimisht ja kaloi Drejtorit të Urbanizmit.

**z.Lulzim Aliu** – Në kuadër të obligimeve ligjore që i kemi konform Ligjit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve është obligim që të jetë një listë rezervë me emrat e rrugëve dhe shesheve, pastaj organi kompetent në këtë rast Drejtoria e Urbanizmit për rrugët e reja që hapën emërtimit t'i bëj nga lista rezervë, lista e cila ka qenë nga Viti 2007/2008, ka qenë një numër i konsiderueshëm i emrave, mirëpo nuk është plotësuar kriteri i mjaftueshëm për nga numëri, andaj është plotësuar me emra të ri propozimi i cili është sjell para jush që ka ardhur nga komisioni i cili është caktuar nga kuvendi para dy viteve dhe ata kanë propozuar këtë listë, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që kjo listë në të ardhmen të plotësohet me emra të ri të cilët mund të propozohen në të ardhmen Komisioni na ka njoftuar se ka biseduar me grupet parlamentare, nuk ka emra të cilët janë të kundërshtuar të cilët gjenden në këtë listë.

**z.Rafiz Sejdiu** – Propozon që kësaj liste e cila është formuluar nga komisioni përkatës t'i shtohet edhe një emër, emri i Fejzullah Çerkinit – i cili ka qenë Drejtor i shkollës normale, Magjistër i Historisë dhe Themelues i Arkivit të Kosovës, mendoj se duhet të kemi kujdes, andaj kërkojë që të futet në këtë listë.

**Kryesuesja e KPF-së dhe KK-së znj. Kristina Gashi Bytyçi** - Pasi që nuk ka diskutime tjera e hedhe në votim, miratohet nga gjithë të pranishmit.

### **5.Propozim - Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtëshme për vitin 2022;**

Fjalën e ka Drejtoresha Sebahate Ajeti Sadiku pastaj e hapë diskutimin.

**znj.Sebahate Ajeti Sadiku** – Përshëndet të pranishmit dhe paraprakisht e bënë një korigjim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, konkretisht këtë vit në propozim është 2021 ndërsa duhet të jetë 2022 në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit 06/L005, për Tatimin e pronës së paluajtëshme neni 9 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 deri në 1.9 thuhet se Kuvendi i Komunës së Ferizajt cakton normat tatimore për vitin 2022, për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë pronë publike si vijonë për të gjitha kategoritë e pronave kemi caktuar normën minimale, këto norma sipas ligjit të sipër cekur parashihen nga 0.15 deri në 0.20, donë të thotë se janë të njëjta sikurse në këtë vit, nuk kemi ndryshuar asgjë donë të thotë janë normat minimale të cilat janë të parapara me ligje dhe si të tilla kërkojmë që të aprovohet.

**znj.Kryesuesja e KPF-së dhe KK-së znj. Kristina Gashi Bytyçi** - Pasi që nuk ka diskutime tjera e hedhe në votime, miratohet nga të gjithë të pranishmit.

**6. Propozim - Vendim për aprovimin e Projekt Buxhetit për Vitin 2022-2024,**

Fjalën e ka Drejtorja e Financave Sebahate Ajeti Sadiku, pastaj e hapë diskutimin.

**znj. Sebahate Ajeti Sadiku** - Lidhur me propozim vendimin në fjalë për periudhën 2022-2024, materialin e keni marrë me kohë, kërkojmë që të procedohet tutje për kuvend sepse data e fundit për aprovim nga organizatat buxhetore është data 30 Shtator 2021, për Buxhetin e Vitit fiskal 2022, në parim ky buxhet në krahasim me vitin aktual ka rritje, mirëpo rritja është theksuar më tepër nga rritja e tavanit të të hyrave vetanake të planifikuara nga Qeverija e Republikës së Kosovës, konkretisht nga Ministria e Financave, andaj kërkojmë që të procedohet për kuvend.

**z. Shkelzen Selmani** - Siç e dimë jemi në kohë fushate kur ka ardhë në kuvend korniza afat mesme buxhetore, unë kam thënë se ky është programi i juaj për qeverisjen e ardhëshme nuk mundësh me dal jashtë kësaj kornize dhe jashtë këtij programi dhe nuk mundësh me premtuar diçka e cila nuk është e përfshinë në kornizën buxhetore, unë e kam lexuar me kujdese këtë Projekt buxhet për vitin 2022-2024, ndërsa projektet të cilat janë të përfshimë në këtë dokument janë projekte të cilat i proklamoi në fushat Kryetari Aliu, ka qenë mirë të jenë edhe drejtorët tjerë sepse kam disa pyetje të cilat kam dashur t'i parashtroi, prap barra po i mbetet Drejtores së Financave që të përgjigjet edhe pse nuk është përgjegjëse për secilën fushë apo drejtori, ndërsa isha fokusuar vetëm në disa pika sepse ky dokument to të diskutohet edhe në kuvend në faqen 15 tek shpenzimet e udhëtimeve zyrtare në vitin 2021 janë parapa 24,602.00€, nuk e di ka ka ndodh ndonjë udhëtim zyrtar gjatë Vitit 2021, me sa e di nuk ka pas udhëtime zyrtare, në vitin 2022 prap është planifikuar shuma e njejtë 24,602.00€, kisha kërkuar shpjegim edhe për shërbimet e ndryshme interne dhe këshilldhënëse 285,209.00€ (dyqind e tetëdhjetë e pesëmijë e dyqind e nëntë euro), gjithashtu e dhe për shërbimet kontraktuese tjera njëmilojnë e treqindë e gjasdhjetë e pesë mijë euro 1,365,000.00€ kjo shifër a është planifikuar për KARITAS Kosovën apo për çfar bëhet fjalë apo janë të planifikume për punëtorët me kontrata në vepër për shërbime të veqanta, kemi edhe te qiraja për makineri 11,000.00€, njëmbëdhjetë mijë euro, a është e planifikuar marrja me qira e veturave për shërbime të komunës apo për çfar konkretisht janë planifikuar këto mjete. Gjithashtu mi analizuar të gjitha veç e veç janë shumë, mirëpo po e parashtroj një pyetje konkrete sa projekte kanë me filluar në Vitin 2022 dhe sa prej tyre kanë me përfunduar po në këtë vit, vetëm një projekt specifikone fatkeqësisht drejtori i infrastrukturës nuk po prezanton në këtë mbledhje sepse kisha disa pyetje konkrete për drejtorin me sa kam pa unë në këtë dokument shumë të rëndësishëm, asnjë projekt nuk fillon dhe përfundon në Vitin 2022. Duke e shikuar dokumentin janë të planifikuar bukur shumë projekte mirëpo du të di se sa janë borxhe prej këtyre projekteve, konkretisht projektet e përfunduara në Vitin 2021 e të cilat do të paguhen në vitin 2022, 2023, 2024, është mirë të specifikohen se cilat janë borxhet të cilat do të mbesin për Vitin 2022, kemi edhe krijimin e hapësirave të gjelbërta janë të parapara 40,000.00 katërdhjetëmijë euro për Vitin 2022, te projektet kapitale, gjithashtu është një projekt për hapësira të gjelbërta te Drejtoria e zhvillimit ekonomik, ndërtimi i parkut të ri në lokacionin egzistues të ndërmarrjes pastërtia 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro) nuk po e kuptoi ndërlihdjen e Drejtorisë së zhvillimit ekonomik me rregullimin e parqeve, mendoi se kjo drejtori ka tjetër qasje, gjithashtu edhe te Drejtoria e Urbanizmit ka në projekt rregullimin i parkut siç po e kuptoi të gjitha, drejtorit janë në garë cila po banë parkun më të mirë, nuk po e shoh në këtë dokument rregullimin e parkut te shkolla e “Gjon Serreqi”.

ndoshta keni menduar me partneritet publiko privat, ne kushta proklamohet 7,000,000.00 shtatëmiljon euro. ndërsa janë të planifikuara 700,000.00 shtatëqind mijë euro, nuk e kuptoi se ka to të realizohet vlera prej 7.000.000.00, shtatëmilion euro, te Drejtoria e Arsim konkretisht shkolla në Fshatin Varrosh është në gjendje shumë të vështirë, me këtë buxhet nuk e vërejtja ndonjë shumë për ndërhyrje në Shkollën e Fshatit Varrosh për renovim apo diçka tjetër, kam edhe shumë shkolla tjera që e kanë gjendjen e njejtë, mirëpo mungesa e drejtorëve nuk di kujt t'ia drejtoj këto çështje, andaj unë nuk e përkrahi këtë projekt buxhet.

**znj.Bahrije Hyseni** – Duke i vërejtur ndryshimet dhe projektet vetëm në kohë fushate dikun me një projekt në vlerë prej 7 milionë a 7 milion e 2 qind mijë ky është mjerim për qytetarët e Ferizajt, atëherë na jena te mashtruar, qytetarin vetëm deri sa ta marrim votën, duke proklamuar se na do të ndajmë Buxhet për Drejtorinë e Bujqësisë në vlerë prej 7,000,000.00 ( shtatëmilion) a në fakt në dokument janë 700,000.00 ( shtatëqind mijë euro) unë kërkoi nga ju drejtorët vlera prej 7,000,000.00 ( shtatëmiljon euro ), ku do të sigurohet apo prej çfar burimi do të mirren.

**znj.Sebahate Ajeti Sadiku** - Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës do të jenë prezent të gjithë drejtorët e drejtorive, sigurisht do t'i merrni përgjigjëjet për të gjitha këto çështje të cilat i ngritët, ajo çka dua të potencoi është se ju e dini që në vitin 2017, kemi pasur një platformë qeverisëse në të cilën Kryetari Agim Aliu ka premtuar investime të cilat do të bëhen në Komunën e Ferizajt, nuk donë të thotë nëse nuk janë në Buxhetin e Komunës për Vitin 2022, nuk do të jenë në të ardhmen sepse ju e dini që kryetari të gjitha premtimet të cilat i ka pasur gjatë Vitit 2017, për këtë mandat qeverisës i ka tejkalluar qysh në vitin e parë të qeverisjes, nuk po e shoh të arsyeshme edhe pse kohë fushate përsëri e kam një mirëkuptim sepse e dimë që kemi edhe kandidat për kuvent të komunës, prap po ua rikujtoj që Kryetari Aliu premtimet të cilat i ka prezantuar i ka përmbushur në vitin e parë të qeverisjes, andaj projektet të cilat po i prezanton në fushat do të përmbushën në mandatin e ardhshëm, duke filluar qysh nga Viti 2022.

**Kryesuesja e Kuvendit Kristina Gashi Bytyçi** - Pasi që nuk ka diskutime tjera miratohet **Propozim - Vendimi për aprovimin e Projekt Buxhetit për vitin 2022-2024, me 5 vota pro dhe 2 kundër kalonë kjo pikë e rendit të ditës.**

**9.Të ndryshme** – Nuk ka pasur diskutime.

**Mbyllja e seancës në ora 10<sup>35</sup> data 24.09.2021**

**Procesmbajtësi**

  
**Islam Ademi**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

  
**Kristina Gashi Bytyçi**